



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.11.2020)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë (vazhdim i mbledhjes plenare datë 21.10.2020).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:00 dhe mbaroi në orën 12:08.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Marçela Shehu | (anëtare) |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*
- 6. Përfaqësues të medias.*

RENDI I DITËS:

1. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë (vazhdim i mbledhjes plenare datë 21.10.2020).

Naureda Llagami: Përsëritje të nderuar anëtarë!

Duke qenë se të gjithë anëtarët janë të pranishëm, fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor datë 05.11.2020.

Siç jeni në dijeni, në këtë rend dite janë përcaktuar 10 çështje për të cilat kërkohet vendimmarrja nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe më konkretisht:

Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 183, datë 28.05.2020, për kandidatin z. {...}”.

Shqyrtimi i projektvendimit për përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, për kandidatin z. {...}.

Shqyrtimi i projektvendimit për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për kandidaten znj. {...}.

Shqyrtimi i projektvendimit për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për kandidaten znj. {...}.

Shqyrtimi i projektvendimit “Për krijimin e bazës së të dhënave në Gjykatën e Lartë dhe dhënie autorizimi për akses në sistemet e menaxhimit të çështjeve gjyqësore”.

Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 07.10.2020”.

Shqyrtimi i 4 projektvendimeve që kanë të bëjnë me rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, dhe pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.

Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës: “Për komandimin në Skemën e Delegimit të gjyqtarit z. {...}”; “Për caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z. {...}, në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë”.

Së fundi është caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Jemi dakord me rendin e ditës?

Nëse jemi dakord, fillojmë me çështjen e parë e cila ka të bëjë me zhvillimin e seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së ILD-së për fillimin e procedimit disiplinor në ngarkim të magjistratit {...}, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Shpallim hapjen e seancës dëgjimore e cila vijon nga mbledhja plenare e datës 21.10.2020. Pas paraqitjes së parashtrimeve nga ana e palëve, Këshilli ka vendosur caktimin e seancës së sotshme, për t’i dhënë mundësi palëve për t’u njohur me dokumentacionin e dosjes personale të magjistratit {...}, që administrohet nga Departamenti i Burimeve Njerëzore.

Çelim seancën. Verifikohet prezenca e a palëve.

Nga ana e Zyrës së Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë u paraqit zoti...?

Artur Metani: Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë dhe Periand Teta, Këshilltar Kabineti i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Naureda Llagami: Nga ana e magjistratit na rezulton që i është përcjellë sot Këshillit një shkresë ku njoftohet se për shkak të gjendjes së tij shëndetësore, jo vetëm të tij por edhe të bashkëshortes, nuk mund të paraqitet në seancën dëgjimore, e cila është një situatë, sipas magjistratit, që dyshohet për COVID në familje. Bashkëshortja, njëkohësisht edhe mbrojtësja e magjistratit, ka kryer testin e COVID-it dhe janë në pritje të rezultateve prej dy ditësh. Ndërkohë gjendja e tyre shëndetësore është rënduar dhe ndodhen të karantinuar në banesë.

Gjithashtu, bashkëlidhur kësaj kërkesë, magjistrati ka përcjellë edhe një raport, i cili është raport për paaftësi të përkohshme në punë, për sëmundje të përgjithshme që paguhen nga punëdhënësi me nr. regjistri 2132 seria a nr. 017820 dhe ky raport është lëshuar edhe nga mjeku përkatës.

Në zbatim të këtij raporti konsiderohet që për magjistratin i është dhënë pushim duke filluar nga data 4 nëntor 2020 deri në datë 7 nëntor 2020.

Ndodhur në këto kushte, nga ana e Këshillit, vlerësohet që jemi në pamundësi për të zhvilluar seancën dëgjimore dhe për më tej kemi vendosur që ta shtyjmë në një seancë tjetër dëgjimore.

Nga ana juaj Inspektor?

Artur Metani: Duke pasur parasysh situatën e përgjithshme për COVID-in dhe gjendjen shëndetësore të magjistratit dhe avokates së tij, pa vënë në dyshim as raportin e lëshuar nga mjeku përkatës, duke pasur parasysh edhe seriozitetin e magjistratit sa i takon paraqitjes dhe mosshtrjes së afateve të procedurave që Këshilli ka pasur deri tani, jam dakord që të shtyhet seanca.

Naureda Llagami: Atëherë, nga ana e Këshillit është vlerësuar si një datë e mundshme për zhvillimin e seancës dëgjimore, data 12 nëntor, ora 12:00.

Jeni dakord me datën?

Artur Metani: Jam dakord me datën për sa i takon Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Sugjerimi im personal është që Këshilli të ketë parasysh edhe afatet e karantinimit, pra duhet menduar mirë kjo çështja e afateve të vendosura. I bie 2 javë. Për mua është dakord.

Naureda Llagami: Atëherë, meqë të gjithë jemi dakord. Këshilli vendosi shtyrjen e seancës dëgjimore ndaj magjistratit {...} në 12 nëntor, ora 12:00.

Artur Metani: Më falni, edhe një gjë.

A ekziston mundësia edhe “online”, mbas dy javësh ose jo, s’ka rëndësi, po them a ekziston mundësia “online” për seancën sepse mund të rezultojë që edhe mbas dy javësh të ketë edhe vendimmarrje të tjera në institucione të tjera që mund të pezullojnë. E thashë për sugjerim.

Naureda Llagami: Dakord. Fiksojmë këtë datë dhe nëse ne do jemi përpara një situatë tjetër, atëherë ne do shprehemi lidhur me mundësinë, duke qenë se lejohet mundësia e zhvillimit të seancës dëgjimore “online”. Të shprehet Këshilli pastaj për mënyrën se si do zhvillojmë më tej seancën dëgjimore pas datës 12.

Artur Metani: Dakord.

Naureda Llagami: Faleminderit për prezencën.

(Dalin nga salla e mbledhjes z. Artur Metani, Inspektor i Lartë i Drejtësisë dhe z. Perian Teta, Këshilltar Kabineti pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.)

Naureda Llagami: Atëherë, për të vijuar mbledhjen, do i sugjeroja kolegëve që të jetë “online” dhe secili në zyrat e veta.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.11.2020)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 183, datë 28.05.2020, për kandidatin z. {...}”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:30 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

10. Marçela Shehu (anëtare)

11. Erjon Muharremaj (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 183, datë 28.05.2020, për kandidatin z. {...}”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

Naureda Llagami: Viojmë me çështjet e tjera të parashikuara në rendin e ditës.

Kalojmë tek çështja e dytë që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 183, datë 28.05.2020, për kandidatin z. {...}”. Për më shumë detaje, fjalën e ka zonja Shehu.

Marçela Shehu: Faleminderit!

Gjyqtari {...} ka kandiduar për disa pozicione të lira në procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në gjykatën e apelit administrativ, konkretisht për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 183, 186, 188 dhe 392 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në rastin e kandidimit të fundit, pra për pozicionin e shpallur me vendimin e Këshillit nr. 392, datë 07.10.2020, ndërsa të gjitha pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile dhe administrative për të cilat kishte kandiduar për ngritje në detyrë pranë gjykatës së apelit ishin në proces, kandidati zoti {...} rikonsideroi

kandidimet e tij, për t'i përcaktuar tre pozicionet për të cilat do të vijonte kandidimin, duke theksuar në kërkesën e parashtruar se tërhiqej nga kandidimi për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 183, datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, duke vijuar kandidimin për pozicionet e lira të shpallura me vendimet nr. 186, 188 datë 28.05.2020 dhe për pozicionin e shpallur me vendimin e Këshillit nr. 392, datë 07.10.2020.

Në këto kushte është hartuar projektvendimi përkatës sipas të cilit i propozohet Këshillit të Lartë Gjyqësor përfundimi i procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 183, datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion. Ky është edhe propozimi për Këshillin.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në vendimmarrje?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 183, datë 28.05.2020, për kandidatin z. {...}, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.11.2020)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:30 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

10. Marçela Shehu (anëtare)

11. Erjon Muharremaj (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Përfaqësues të misionëve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}”, përparitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja e radhës që ka të bëjë me përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për kandidatin z. {...}, relator i të cilit do jetë zoti Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Zoti {...} ka kandiduar për tre pozicione të lira për ngritje në detyrë, dy nga të cilat janë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, respektivisht pozicionet e shpallura me vendimet nr. 184 dhe nr. 185, datë 28 maj 2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Për këto dy kandidime të zotit {...} në Gjykatën e Apelit Tiranë është përfunduar në fakt edhe procedura e verifikimit paraprak të tre kriterëve, ndërkohë po vijon dhe procedura sa i përket verifikimit të pasurisë dhe figurës që është e ndërvarur edhe nga përfundimi i procesit të rivlerësimit kalimtar për gjyqtarin {...}.

Ndërkohë, zoti {...} ka paraqitur një kërkesë përpara Këshillit të Lartë Gjyqësor, nëpërmjet të cilës ka hequr dorë nga kandidimi për dy pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale në Gjykatën e Apelit Tiranë. Kjo kërkesë është depozituar pranë Këshillit më datë 26 tetor 2020. Nisur nga kjo, referuar edhe përcaktimeve të bërë në Rregulloren e Këshillit të miratuar me vendimin nr. 75/2019 por edhe Kodit të Procedurave Administrative sa kohë kjo procedurë ngritjeje në detyrë për zotin {...} ka filluar me kërkesën e tij dhe në kushtet kur kërkesa për kandidim tërhiqet, i propozoj Këshillit në cilësinë e relatorit që të vendosë përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionet e lira në fushën e së drejtës penale të shpallura me vendimet nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këto pozicione. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim mbi projekt-aktin e propozuar?

Nëse jo, kalojmë në votimin e tij, sipas propozimit të bërë nga Komisionit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Përfundimin e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 183, datë 28.05.2020, për kandidatin z. {...}, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

(Në fakt, gabimisht lexohet sërish miratimi i pikës së dytë të rendit të ditës që u miratua pak më parë.)

Këshilli, sapo miratoi përfundimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, të shpallura me vendimet nr. 184 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatin z. {...}, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.11.2020)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:30 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

10. Marçela Shehu (anëtare)

11. Erjon Muharremaj (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin tjetër i cili ka të bëjë me përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për kandidaten znj. {...}. Edhe këtu relator është zoti Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, zonja {...} ka kandiduar për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm si dhe në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Sa i përket procedurës së ngritjes në detyrë për në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, përmes shortit, si relator për verifikimin e kësaj kandidateje jam caktuar unë.

Rezulton se në këtë procedurë kandidimi të jetë përfunduar verifikimi i paraprak për katër kriteret formale të kandidimit për zonjën {...}, ndërkohë që gjatë kësaj

procedure, ajo ka paraqitur një kërkesë përmes së cilës tërhiqet nga kandidimi për në Gjykatën e Posaçme të Apelit, ndërsa ka konsideruar që të kandidojë edhe për një pozicion tjetër të lirë të shpallur së fundmi për në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, pra për të ndenjur brenda tre pozicioneve që janë në proces pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Nisur nga kërkesa e zonjës {...} që është depozituar pranë Këshillit më datë 22 tetor 2020, në cilësinë e relatorit, pasi është trajtuar rasti edhe në Komision, i propozoj Këshillit që të vendosë përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kemi ndonjë diskutim për këtë?

Nëse jo, kalojmë në votim?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.11.2020)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendim nr.174, datë 28.05.2020, për kandidaten znj. {...}”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:30 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Marçela Shehu | (anëtare) |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendim nr.174, datë 28.05.2020, për kandidaten znj. {...}”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Naureda Llagami: Kalojmë në aktin tjetër, i cili ka të bëjë me përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për kandidaten znj. {...}, relator i të cilit është zoti Toro.

Alban Toro: Më herët me vendimet 174, 184 dhe 185 të datës 28.05.2020 nga ana e Këshillit janë hapur disa pozicione të lira në fushën e së drejtës penale, përkatësisht në Gjykatën e Apelit Durrës dhe Tiranë dhe në këto pozicione, një nga kandidatet është edhe zonja {...} për të cilin është bërë edhe verifikimi paraprak për tre kriteret, ku është disponuar më pas me vendim të veçantë të Këshillit dhe konkretisht me vendimin nr. 284, 08.09.2020, duke vendosur vijimin e procedurës së verifikimit për këtë kandidatë për kriteret e tjera ligjore.

Më pas, në respekt të nenit 48, pika 6 e ligjit 96/2016, nga ana e kandidates është vijuar me një kërkesë ku nëpërmjet saj thotë që tërheqë dorë nga kandidimi i mëparshëm lidhur me vendin e shpallur me vendimin nr. 174 datë 28.05.2020 në Gjykatën e Apelit Durrës (në fushën penale), duke rikonsideruar kandidimin e saj për një pozicion tjetër të

shpallur me vendimin nr. 396, datë 07.10.2020 si gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë, në fushën e së drejtës penale.

Në këto kushte, në respekt të rregullores 75/2019, në momentin kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori i çështjes përgatit relacionin duke paraqitur procedurën e zhvilluar dhe projekt-aktin për përfundimin e procedurës së verifikimit të kandidatit të tërhequr duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit dhe njëkohësisht ky i fundit Këshillit.

Nga ana e Komisionit është përgatitur projekt-drafti, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendim nr.174, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet zonjës {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të ligjit 115/2016. Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Kalojmë në vendimmarrje nëse jemi dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me vendim nr.174, datë 28.05.2020, për kandidaten znj. {...}.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.11.2020)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për krijimin e bazës së të dhënave në Gjykatën e Lartë dhe dhënie autorizimi për akses në sistemet e menaxhimit të çështjeve gjyqësore”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:30 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Marçela Shehu | (anëtare) |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për krijimin e bazës së të dhënave në Gjykatën e Lartë dhe dhënie autorizimi për akses në sistemet e menaxhimit të çështjeve gjyqësore”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Projekt-akti tjetër ka të bëjë me krimin e bazës së të dhënave në Gjykatën e Lartë dhe dhënien e autorizimit për akses në sistemet e menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Projekt-akt i cili do të raportohet nga zoti Muharremaj.

Erjon Muharremaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në bazë dhe për zbatim të nenit 147/a të Kushtetutës, të neneve 61, 89, 92 pika 2 dhe të nenit 94 të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të neneve 36 dhe 47 të Ligjit nr. 98/2016 “ Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ka detyrimin të mirëmbajë dhe administrojë bazën e të dhënave në gjykata, të mbajtura në formë elektronike nëpërmjet sistemeve kompjuterike.

Me shkresën nr. 2366 prot., datë 13.10.2020, Gjykata e Lartë, ka përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor kërkesën nëpërmjet të cilës kërkohet “Dhënia e aksesit ekspertëve të EURALIUS në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS dhe ARK-IT) për të gjitha Gjykatat Shqiptare, në mënyrë që të krijojnë këtë bazë të dhënash.

Është e vetëkuptueshme se ekspertet e EURALIUS-it të angazhuar në këtë veprimtari do të nënshkruajnë një Deklaratë Konfidencialiteti para fillimit të kësaj veprimtarie”.

Sistemi aktual nuk lejon transferimin dhe regjistrimin plotësisht të automatizuar të çështjeve hyrëse. Gjyqtarët dhe këshilltarët ligjorë nuk kanë akses në versionin elektronik të vendimeve dhe materialeve të tjera të lidhura me çështjet nga gjykatat e shkallëve më të ulëta.

Pranë gjykatave të shkallëve të para si dhe gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm, gjykatave administrative të shkallëve të para, Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe Gjykatës së Lartë, funksionon Sistemi Informatik i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS), ndërsa në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është funksionon Sistemi i Administrimit të Çështjeve Gjyqësore (ARK-IT).

Gjykata e Lartë ka asistencën e misionit EURALIUS V, i cili propozon që të nxirren vendimet nga baza e të dhënave të gjykatave të shkallëve më të ulëta dhe të krijohet një bazë të dhënash brenda Gjykatës së Lartë me të gjithë vendimet e disponueshme në programin kompjuterik “Word” dhe duke pasur këto të dhëna, shmanget rikrijimi, pra shtypja nga e para e të gjithë këtyre të dhënave në kompjuter, duke sjellë kështu shkurtimin e kohës së nevojshme për trajtimin e çështjeve.

Ekspertët e misionit EURALIUS V do të zhvillojnë një mini aplikacion, i cili mund të përdoret për nxjerrjen e vendimeve nga gjykatat e shkallëve më të ulëta, mbështetur në çështjet e regjistruara në Gjykatën e Lartë. Ky mini aplikacion do të sigurojë që të merren vendimet e nevojshme në mënyrë sa më efçente për Gjykatën e Lartë.

Bazuar në sa më sipër, Gjykata e Lartë kërkon dhënien e autorizimit nga ana jonë, për t’iu dhënë akses ekspertëve të misionit EURALIUS V në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve (ICMIS dhe ARK-IT) për të gjithë gjykatat në Shqipëri, në mënyrë që të krijojnë këtë bazë të dhënash. Ekspertët e angazhuar në këtë veprimtari do të nënshkruajnë një Deklaratë Konfidencialiteti para fillimit të veprimtarisë së tyre.

Aksesi për nxjerrjen e vendimeve nga të dhënat bazë në Sistemet Informatike të Menaxhimit i jepen nëpunësit përgjegjës për Teknologjinë e Informacionit të Gjykatës së

Lartë, i cili do të asistohet nga ekspertët e Misionit EURALIUS V, me qëllim krijimin e një baze të dhënash në Gjykatën e Lartë me të gjitha vendimet që disponojnë në programin “Word” (siç thashë pak më sipër, për të shmangur rikrijimin nga e para të të dhënave).

Për sa më lart, në mbështetje të neneve 61, 89, 92 pika 2 dhe të nenit 94 të Ligjit “Për organet e qeverisjes”, të neneve 36 dhe 47 të Ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale ka përgatitur projektvendimin “Për dhënie autorizimi për akses në sistemet e menaxhimit të çështjeve gjyqësore”.

Në pikën I të projektvendimit përcaktohet krijimi i bazës të të dhënave, të vendimeve gjyqësore të shkallëve më të ulëta, në programin “Word”.

Në pikën II të projektvendimit përcaktohet dhënia e aksesit për nxjerrjen e vendimeve nga Sistemet Informatike ICMIS dhe ARK-IT.

Në pikën III të projektvendimit përcaktohet se ekspertët e Misionit EURALIUS V do të kenë akses në sistem, vetëm në praninë (fizike ose “online”) të nëpunësit përgjegjës për Teknologjinë e Informacionit të Gjykatës së Lartë, si dhe të nëpunësit përgjegjës për Teknologjinë e Informacionit të gjykatës nga ku do të merren të dhënat, dhe/ose të nëpunësit përgjegjës për Teknologjinë e Informacionit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas rastit.

Në pikën IV të projektvendimit përcaktohet se përpara fillimit të krijimit të kësaj baze të dhënash, të gjithë personat e ngarkuar, detyrohen të nënshkruajnë Deklaratën e Konfidencialitetit.

Lidhur me afatin e kohëzgjatjes, Komisioni propozon dhënien e aksesit për të marrë të dhënat nga baza e Sistemeve ICMIS dhe ARK-IT, deri në momentin e mundësisimit të transferimit elektronik të të të dhënave të dosjes, nga një gjykatë në tjetrën.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, kemi diskutim?

Nëse jo, kalojmë në miratimin e projekt-aktit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi krijimin e bazës së të dhënave në Gjykatën e Lartë dhe dhënien e autorizimit për akses në sistemet e menaxhimit të çështjeve, sipas propozimit të bërë nga relatori.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.11.2020)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 07.10.2020”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:30 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)

10. Marçela Shehu (anëtare)

11. Erjon Muharremaj (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 07.10.2020”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska).

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës, i cili ka të bëjë me fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 07.10.2020. Për më shumë detaje fjalën ia jap zotit Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përkatitur projektvendimin “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 07.10.2020”. Krahas projektvendimit, bashkëlidhur është dërguar edhe relacioni shpjegues në lidhje me këtë projektvendim.

Shkurtimisht mund t'ju sqaroj se, sipas nenit 147/a, pika 1, shkronja "a", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndër të tjera, ushtron edhe funksionin e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve.

Funksioni kushtetues si më lart i Këshillit të Lartë Gjyqësor, që lidhet me zhvillimin e karrierës gjyqësore, gjen rregullim të mëtejshëm në Ligjin "Për organet e qeverisjes së drejtësisë", i ndryshuar, pikërisht në nenin 86, shkronja "ç", ndërkohë që në shkronjën "ë" të kësaj dispozite, parashikohet përgjegjësia e Këshillit në lidhje me çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj në lidhje me zhvillimin e karrierës gjyqësore.

Po ashtu, përgjegjësia e Këshillit të Lartë Gjyqësor për çështjet që lidhen me zhvillimin e karrierës gjyqësore dhe konkretisht sa i përket ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në shkallët më të larta, gjen rregullim edhe në Ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", pikërisht në nenin 48, ndërkohë që në pikën 7 të kësaj dispozite, përcaktohet detyrimi i Këshilli për verifikimin e kandidatëve që konkurrojnë për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta ose të specializuara, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji.

Lidhur me verifikimin e kandidatëve në kuadër të zhvillimit të karrierës gjyqësore, përfshirë edhe për ata që kandidojnë për ngritjen në detyrë në shkallët më të larta, siç janë gjykatat e apelit, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar procedura të detajuara përmes Vendimit nr. 75, datë 23.05.2019. Sipas këtij akti nënligjor, konkretisht Kreut V, Seksioni A, pika 1, shkronja "c", procedura e verifikimit të kandidatëve fillon me vendim të Këshillit, ndër të tjera, "jo më vonë se 7 ditë nga përfundimi i afatit të kandidimit të gjyqtarëve për ngritjen në detyrë".

Pikërisht, në respektim të këtij rregulli, Këshilli duhet të disponojë për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për kandidatët që kanë kandiduar për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e tij nr.389, nr.392, nr.394, nr.395 dhe nr.396, datë 07.10.2020, afati i kandidimit për të cilët ka përfunduar më datë 23.10.2020.

Duhet përmendur se, më datë 07.10.2020, përmes Vendimeve nr.390 dhe nr.397, Këshilli ka rihapur ose hapur procedurat e ngritjes në detyrë edhe për një pozicion të lirë në Gjykatën e Apelit Korçë dhe për një pozicion të lirë në Gjykatën e Apelit Vlorë, procedura në të cilat nuk aplikoi asnjë gjyqtar. Për rrjedhojë, në mungesë të kandidatëve

në këto procedura ngritjeje në detyrë, nuk ka vend për të vendosur fillimin e procedurës së verifikimit për ta.

Në vijim, sipas Kreut V, Seksioni A, pika 2, të aktit nënligjor si më lart, “Në të njëjtën ditë të mbledhjes së Këshillit zhvillohet edhe procedura e shortit për caktimin, ndërmjet anëtarëve të Komisionit, të relatorit për secilin kandidat”. Në zbatim të këtij rregulli, Këshilli, në të njëjtën ditë të mbledhjes kur do të vendosë për fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr.389, nr.392, nr.394, nr.395 dhe nr.396, datë 07.10.2020, do të duhet të caktojë dhe relatorin për secilin kandidat, nëpërmjet hedhjes së shortit midis anëtarëve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

Referuar kandidaturave të paraqitura për secilin nga pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr.389, nr.392, nr.394, nr.395 dhe nr.396, datë 07.10.2020, në total 8 kandidatë, rezulton se 3 prej tyre kanë kandiduar edhe më parë për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit apo në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm. Konkretisht këta kandidatë janë z. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}.

Për një situatë të tillë, në Kreun VI, Seksioni B, pika 7, të aktit nënligjor si më lart, është parashikuar se “Në rastin e kandidatit që ka kandiduar njëkohësisht në më shumë se një pozicion të lirë në proces shqyrtimi nga Këshilli, procedura standarde verifikuese e realizuar në rastin më të parë është e vlefshme për çdo procedurë tjetër kandidimi të atëkohshme”. Në kuptim dhe zbatim të këtij rregulli, për tre kandidatët që kanë kandiduar për disa pozicione të lira në proces shqyrtimi, sa i përket kriterëve të pasurisë dhe figurës, që janë të njëjtë për çdo lloj kandidimi, procedura e verifikimit që është në proces e sipër në lidhje me to, do të duhet të konsiderohet e vlefshme edhe për kandidimin e tyre për pozicionet e lira në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, të shpallura me Vendimet nr.389, nr.392, nr.394, nr.395 dhe nr.396, datë 07.10.2020.

Sa i përket tre kandidatëve që kanë kandiduar në procedurat e ngritjes në detyrë për pozicionet e shpallura më datë 28.05.2020 dhe 07.10.2020, të dhënat për kandidimet e tyre janë si më poshtë:

Kandidati z.{...} - ka kandiduar në total për 4 pozicione të lira që janë në proces dhe konkretisht: - për një pozicion të lirë në Gjykatën e Apelit Tiranë, të shpallur me

Vendimin nr.180, datë 28.05.2020; - për një pozicion të lirë në Gjykatën e Apelit Vlorë, të shpallur me Vendimin nr.186, datë 28.05.2020; - për një pozicion të lirë në Gjykatën Administrative të Apelit, të shpallur me Vendimin nr. 188, datë 28.05.2020; - si dhe për një pozicion të lirë në Gjykatën e Apelit Durrës, të shpallur me Vendimin nr.392, datë 07.10.2020;

Kandidatja znj. {...} - ka kandiduar në total për 4 pozicione të lira që janë në proces dhe konkretisht: - për një pozicion të lirë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të shpallur me Vendimin nr. 91, datë 26.02.2020; - për dy pozicione të lira në Gjykatën e Apelit Tiranë, të shpallura me Vendimet nr.181 dhe nr. 183, datë 28.05.2020; - si dhe për një pozicion të lirë në Gjykatën e Apelit Tiranë, të shpallur me Vendimin nr.394, datë 07.10.2020;

Kandidatja znj. {...} - ka kandiduar në total për 4 pozicione të lira që janë në proces dhe konkretisht: - për dy pozicione të lira në Gjykatën e Apelit Tiranë, të shpallura me Vendimet nr. 184 dhe nr.185, datë 28.05.2020; - për një pozicion të lirë në Gjykatën e Apelit Durrës, të shpallur me Vendimin nr. 174, datë 28.05.2020; - si dhe për një pozicion të lirë në Gjykatën e Apelit Tiranë, të shpallur me Vendimin nr. 396, datë 07.10.2020.

Siç është e ditur, Këshilli ka diskutuar dhe ka mbajtur qëndrim lidhur me interpretimin dhe zbatimin e pikës 6, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Referuar këtij qëndrimi, i cili ka qenë pjesë e njoftimeve publike për njoftimin për hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në gjykata apelit të juridiksionit të përgjithshëm, rezulton se të tre kandidatët si më lart, në rastin e kandidimeve të bëra rishtazi, pra të kandidimeve të katërta, të kenë rikonsideruar kandidimet e tyre në tërësi, duke u tërhequr nga një prej kandidimeve të mëparshme. Për këtë, pak më herët ne vendosëm përfundimin e procedurave për z. {...} për sa i përket procedurës së ngritjes në detyrë për pozicionin e lirë në Gjykatën e Apelit Tiranë, të shpallur me Vendimin nr.180, datë 28.05.2020, duke mbetur kështu në proces tre kandidime për zotin Pëllumbi; Për kandidaten {...} pak më parë Këshilli vendosi përfundimin e procedurës për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, duke mbetur kështu në procedurë

kandidimi zonja Kacerja vetëm për tre pozicione të lira. Po kështu edhe për kandidaten zonja {...}, Këshilli pak më parë vendosi përfundimin e procedurës së kandidimit sa i përket kandidimi të saj për ngritjen në detyrë për pozicionin e lirë në Gjykatën e Apelit Durrës, të shpallur me Vendimin nr. 174, datë 28.05.2020, duke mbetur kështu edhe zonja {...} si kandidate e vetme për tre pozicione të lira që janë në proces shqyrtimi.

Ndërkohë, në procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, të hapura apo të rihapura më datë 07.10.2020, kandidoi edhe gjyqtari z. {...}. Ai kandidoi për 7 pozicione të lira. Në relacion janë evidentuar të 7 pozicionet e lira ku zoti {...} kandidoi. Për këtë shkak, për sa kohë kishte kaluar numrin 3 të pozicioneve të lira për të cilat mund të kandidonte, ai është njoftuar në rrugë elektronike nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe pas kësaj, më datë 29.10.2020, rikonsideroi kandidimet e tij duke vijuar kandidimet vetëm për tre pozicione të lira të cilat të treja evidentohen në relacionin respektiv që i është bashkëlidhur projektvendimit.

Lidhur me strukturën e projektvendimit, ai përbëhet nga 5 pika.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet fillimi i procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr.389, nr.392, nr.394, nr.395 dhe nr.396, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pika 2 e projektvendimit bën fjalë për caktimin e relatorit për secilin nga 5 kandidatët për pozicionet e lira, për të cilat fillon procedura e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit sipas pikës 1 të projektvendimit (konkretisht kandidatët janë {...}, {...}, {...}, {...}.)

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se për kandidatët z. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}, të cilët kanë kandiduar më parë për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit ose në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, procedurat e verifikimit sa i përket pasurisë dhe figurës që janë në proces e sipër për këto kandidime, janë të vlefshme edhe për kandidimet e tyre për pozicionet e lira në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, respektivisht për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr.392, nr.394 dhe nr.396, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndërkohë, pika 4 e projektvendimit bën fjalë për mosfillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit

Tiranë, për pozicionet e shpallura me Vendimet nr.394 dhe nr.396, datë 07.10.2020, për kandidatin z.{...}, në kushtet e tërheqjes së tij nga kandidimi për këto pozicione, më datë 29.10.2020, pra përpara fillimit të procedurës së verifikimit të kandidatëve.

Pika 5 e projektvendimit bën fjalë për mosfillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Shkodër, për pozicionet e shpallura me Vendimet nr.391 dhe nr.393, datë 07.10.2020, në kushtet e tërheqjes nga kandidimi për këto pozicione, të kandidatit të vetëm z.{...}, tërhequr më datë 29.10.2020, pra përpara fillimit të procedurës së verifikimit të kandidatëve.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Sa i përket ndarjes së ngarkesës pra të procedurave të verifikimit mes anëtarëve të Komisionit, Komisioni i propozon Këshillit që këto procedura të ndahen mes anëtarëve të tij (zoti Toska një nga kandidatët për verifikim, zoti Toro dhe zonja Shehu nga dy kandidatë për verifikim).

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Pas relatimit nga zoti Toska fillon procedura e shortit.

(Sqarohet se gjatë hedhjes së shiritave të emrave të relatorëve në enën e qelqit, gabimisht emri i relatores zonjës Shehu dhe emri i relatorit zotit Toro hidhen dy herë, në vend të një.)

Pasi futen tre emrat e relatorëve në enën e qelqit dhe emrat e gjyqtarëve kandidatë në enën tjetër të qelqit, dhe pas përzgjedhjes një nga një të tyre, shorti rezulton si më poshtë:

Për kandidaten znj. {...} - relator z.Alban Toro; 2. Për kandidaten znj. {...} - relatore znj. Marçela Shehu; 3. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Ilir Toska; 4. Për kandidaten znj. {...} - relatore znj. Marçela Shehu; 5. Për kandidatin z. {...} - relator z.Alban Toro.

Më tej kalohet në votimin e projekt-aktit.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr.389, nr.392, nr.394, nr.395 dhe nr.396, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: 1. Për kandidaten znj. {...} - relator z.Alban Toro; 2. Për kandidaten znj. {...} - relatores znj. Marçela Shehu; 3. Për kandidaten znj. {...} - relator z. Ilir Toska; 4. Për kandidaten znj. {...} - relatores znj. Marçela Shehu; 5. Për kandidatin z. {...} - relator z.Alban Toro.

3. Për kandidatët z. {...}, znj. {...} dhe znj. {...}, të cilët kanë kandiduar më parë për ngritjen në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit ose në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, procedurat e verifikimit sa i përket pasurisë dhe figurës që janë në proces e sipër për këto kandidime, janë të vlefshme edhe për kandidimet e tyre për pozicionet e lira në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, respektivisht për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 392, nr. 394 dhe nr. 396, datë 07.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

4. Mosfillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e shpallura me Vendimet nr. 394 dhe nr. 396, datë 07.10.2020, për kandidatin z. {...}, në kushtet e tërheqjes së tij nga kandidimi për këto pozicione, më datë 29.10.2020.

5. Mosfillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Shkodër, për pozicionet e shpallura me Vendimet nr. 391 dhe nr. 393, datë 07.10.2020, në kushtet e tërheqjes nga kandidimi, më datë 29.10.2020, për këto pozicione, të kandidatit të vetëm z. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.11.2020)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i 4 projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska):

8.1 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion në fushën e të drejtës penale”.

8.2 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion në fushën e të drejtës civile”.

8.3 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion në fushën e të drejtës penale”.

8.4 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, për një pozicion në fushën e të drejtës penale”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:30 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)

5. *Brunilda Kadi* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Illir Toska* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)
11. *Erjon Muharremaj* (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
4. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
5. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i 4 projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Ilir Toska):

8.1 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion në fushën e të drejtës penale”.

8.2 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion në fushën e të drejtës civile”.

8.3 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion në fushën e të drejtës penale”.

8.4 “Për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, për një pozicion në fushën e të drejtës penale”.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e radhës sipas rendit të ditës i cili ka të bëjë me rihapjen e procedurave për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion të lirë në të drejtën penale. Fjalën ia jap zotit Toska.

Illir Toska: Faleminderit!

Atëherë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur në fakt katër projektvendime për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, Shkodër dhe Vlorë, secilin nga këto për një pozicion të lirë në fushën e së drejtës civile ose në fushën e së drejtës penale. Për të katër projektvendimet është përgatitur një relacion shpjegues.

Shkurtimisht mund t'ju them se, Këshilli i Lartë Gjyqësor pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuara nga ligji, më datë 28.05.2020, hapi procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në disa gjykata apelit të juridiksionit të përgjithshëm, ndër to në Gjykatën e Apelit Korçë për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale sipas Vendimit nr.177, si dhe në Gjykatën e Apelit Shkodër për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile sipas Vendimit nr.178.

Brenda afatit të kandidimit për këto dy procedura ngritjeje në detyrë, që përfundoi më datë 15.06.2020, nuk kandidoi asnjë gjyqtar.

Në kushtet e moskandidimit të asnjë gjyqtari në procedurat si më lart të ngritjes në detyrë, ndërsa vijonte të ekzistonte nevoja për plotësimin e tyre, Këshilli vendosi të rihapte procedurat e ngritjes në detyrë pranë këtyre gjykatave. Konkretisht: me Vendimin nr. 228, datë 02.07.2020, Këshilli rihapi procedurën e ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale; me Vendimin nr. 229, datë 02.07.2020, Këshilli rihapi procedurën e ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Brenda afatit të kandidimit për këto dy procedura ngritjeje në detyrë, që përfundoi më datë 19.07.2020, përsëri nuk kandidoi asnjë gjyqtar.

Edhe mbas kësaj, për të njëjtat shkaqe, Këshilli vendosi të rihapte procedurat e ngritjes në detyrë pranë këtyre dy gjykatave. Konkretisht: me Vendimet nr. 299 dhe 298 të datës 10 shtator 2020.

Edhe në këtë rast, brenda afatit të kandidimit për këto dy procedura ngritjeje në detyrë, që përfundoi më datë 24.09.2020, nuk kandidoi përsëri asnjë gjyqtar.

Edhe mbas kësaj, për të njëjtat shkaqe, Këshilli vendosi të rihapte procedurat e ngritjes në detyrë pranë këtyre dy gjykatave. Konkretisht: me Vendimet nr. 390 dhe 391, të datës 07.10.2020.

Brenda afatit të kandidimit për këto dy procedura ngritjeje në detyrë, që përfundoi më datë 23.10.2020, nuk kandidoi përsëri asnjë gjyqtar.

Ndërsa në Gjykatat e Apelit Korçë dhe Shkodër, vijojnë të ekzistojnë pozicionet e lira në fushat përkatëse të së drejtës si më lart, si dhe nevojat urgjente për plotësimin e tyre, mbështetur në pikën 1, të nenit 147 dhe në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikat 2 dhe 3, të nenit 8, në shkronjën “a”, të pikës 1 dhe në pikën 4, të nenit 47, në pikën 2, në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 3, në pikat 5, 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 61, në shkronjën “ç”, të nenit 86 dhe në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 97, të Ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar dy projektvendime për rihapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në këto dy gjykata apeli të juridiksionit të përgjithshëm.

Gjithashtu, pas krijimit rishtazi të dy pozicioneve të lira, respektivisht në Gjykatën e Apelit Shkodër dhe në Gjykatën e Apelit Vlorë, Këshilli, më datë 07.10.2020, vendosi të hapte procedurat e ngritjes në detyrë pranë këtyre gjykatave. Konkretisht: me Vendimet nr. 393 dhe 397, datë 07.10.2020.

Brenda afatit të kandidimit për këto dy procedura ngritjeje në detyrë, që përfundoi më datë 23.10.2020, nuk kandidoi asnjë gjyqtar.

Ndërsa në Gjykatat e Apelit Shkodër dhe Vlorë, vijojnë të ekzistojnë pozicionet e lira në fushën e të drejtës penale, si dhe nevojat urgjente për plotësimin e tyre, mbështetur po në të njëjtën bazë ligjore, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar edhe dy

projektvendime të tjera për rihapjen e procedurave të ngritjes në detyrë në këto dy gjykata apeli të juridiksionit të përgjithshëm.

Sa i përket përmbajtjes së katër projektvendimeve, ato janë të strukturuar në 4 Krerë, me të njëjtën përmbajtje si dhe në rastin e hapjes dhe të rihapjes së këtyre procedurave të ngritjes në detyrë, me përjashtim të afatit të kandidimit, i cili është përcaktuar “deri më datë 20.11.2020”.

Bashkëlidhur projektvendimeve janë edhe dy formularët tip, që kandidatët duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë në momentin e aplikimit, konkretisht: i) formulari - Vetëdeklarim për masë disiplinore dhe ii) formulari - Vetëdeklarim për situatën e papajtueshmërisë ambientale. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Si mendoni, të kalojmë në votim çdo vendim?

Ilir Toska: Çdo vendim duhet votuar.

Naureda Llagami: Kështu, kalojmë në votim vendimin e parë i cili ka të bëjë me rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale. Afati i kandidimit është data 20.11.2020. Jemi dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi propozimin e ardhur nga Komisioni për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Korçë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale.

Kalojmë në projekt-aktin tjetër për rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile, me një afat kandidimi deri më datë 20.11.2020. Jemi dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile, sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

Kalojmë në projekt-aktin tjetër që ka të bëjë me rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, me një afat kandidimi deri më datë 20.11.2020. Jemi dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale.

Kalojmë në aktin e fundit që ka të bëjë me rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, me një afat kandidimi deri më datë 20.11.2020. Jemi dakord?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi rihapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale, sipas propozimit të bërë nga Komisioni.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.11.2020)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:

9.1 “Për komandimin në Skemën e Delegimit të gjyqtarit z. {...}”;

9.2 “Për caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z. {...}, në Gjykatën e Apelit Gjirokastër”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:30 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |

10. Marçela Shehu (anëtare)

11. Erjon Muharremaj (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës:

9.1 “Për komandimin në Skemën e Delegimit të gjyqtarit z. {...}”;

9.2 “Për caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z. {...}, në Gjykatën e Apelit Gjyrokastër”.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin e radhës, që ka të bëjë me komandimin në Skemën e Delegimit të gjyqtarit z. {...}. Lidhur me këtë projekt-akt relator është z. Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për komandimin në Skemën e Delegimit të gjyqtarit z. {...}”. Krahas projektvendimit keni edhe relacionin shpjegues lidhur me këtë projektvendim. Shkurtimisht mund t’ju them se më datë 27 tetor 2020, gjyqtari {...}, aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, ka paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor një kërkesë për shprehje interesi, nëpërmjet të cilës ka dhënë pëlqimin për të shërbyer në skemën e delegimit në çdo gjykatë të Republikës së Shqipërisë.

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se gjyqtari {...} ka marrë titullin Jurist, nga Universiteti i Tiranës në vitin 2010. Ai ka mbaruar Shkollën e

Magjistraturës në vitin 2014. Fillimin në detyrë e ka me Dekretin e Presidentit të Republikës të datës 21.10.2013, nëpërmjet të cilit është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Më pas, me Dekretin e Presidentit të Republikës të datës 25.09.2015, ai është emëruar gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, ku vijon të ushtrojë funksionin dhe aktualisht.

Neni 45 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përcakton rregullimin ligjor lidhur me organizimin dhe funksionimin e skemës së delegimit, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen nga magjistratët për t’u pranuar në këtë skemë si dhe detyrimin e Këshillit për të miratuar rregulla të detajuara për kriteret dhe procedurën për përzgjedhjen e magjistratëve si dhe kohën e shërbimit për skemën e delegimit, duke parashikuar ndër të tjera se: “ 1. Magjistratët në të gjitha shkallët, me të paktën një vit përvojë në funksion, mund të kandidojnë për t’u komanduar në një pozicion, në skemën e delegimit, e cila krijohet në Këshill. 2. Magjistrati shërben në skemën e delegimit jo më shumë se 5 vjet. 3. Magjistrati që kandidon për pozicione në skemën e delegimit, nënshkruan një deklaratë për dhënien e pëlqimit për t’u caktuar në çdo gjykatë ose prokurori.”

Në zbatim të nenit 45 të ligjit për Statusin, Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 22, datë 07.02.2019, ka miratuar Rregulloren për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit. Konkretisht neni 4 i kësaj rregulloreje parashikon kriteret e kandidimit në skemën e delegimit, si vijon:

“Në skemën e delegimit kandidon çdo gjyqtar që plotëson këto kriteret:

- a. Të ketë dhënë pëlqimin për t’u komanduar në skemën e delegimit;
- b. Të ketë jo më pak se 1 vit përvojë në funksion;
- c. Të mos jetë nën efektet e një mase disiplinore, zbatimi i së cilës mund të shmanget për shkak të përfshirjes në skemën e delegimit;
- d. Të mos ushtrojë funksionin e Kryetarit apo Zëvendëskryetarit;
- e. Të mos jetë i caktuar në mënyrë të përhershme në një gjykatë ku komandimi cenon funksionalitetin e saj;
- f. Të mos jetë duke ushtruar funksionin e tij si gjyqtar në një gjykatë tjetër për shkak të transferimit të përkohshëm me ose pa pëlqim”.

Bazuar në rrethanat e faktit të parashtruara më sipër, në lidhje me parashikimet ligjore të nenit 45 të Ligjit për Statusin si dhe në lidhje me parashikimet e Vendimit nr. 22, datë 07.02.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni vlerëson se në rastin konkret, jemi në kushtet e pranimit të përfshirjes së gjyqtarit {...} në skemën e delegimit, pra të komandimit të tij në këtë skemë pasi: gjyqtari ka dhënë pëlqimin për t'u komanduar në skemën e delegimit; ka më shumë se 1 vit përvojë në funksion; nuk ndodhet nën efektet e një mase disiplinore, zbatimi i së cilës mund të shmanget për shkak të përfshirjes në skemën e delegimit; nuk ushtron funksionin e Kryetarit apo Zëvendëskryetarit; është e caktuar në mënyrë të përhershme në një gjykatë ku komandimi nuk cenon funksionalitetin e saj pasi aktualisht rezulton se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë ushtrojnë funksionin 5 gjyqtarë, ndërsa organika e saj është 6 të tillë; nuk rezulton të jetë duke ushtruar funksionin e tij si gjyqtar në një gjykatë tjetër për shkak të transferimit të përkohshëm me ose pa pëlqim.

Sa më sipër, konkludohet se gjyqtari {...} plotëson kriteret për t'u komanduar në skemën e delegimit.

Në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor që të vendosë: 1. Pranimin e kërkesës së gjyqtarit z. {...}. 2. Komandimin e gjyqtarit z. {...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat deri në një vit, që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave. 3. Përfshirjen e gjyqtarit z. {...} nga procedurat e shortit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. 4. Gjyqtari i skemës së delegimit, z. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, për të cilat ka përfunduar apo është në përfundim hetimi gjyqësor. 5. Efektet juridike të vendimit fillojnë data e njoftimit.

6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Atëherë, keni ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi komandimin në skemën e delegimit të gjyqtarit {...}, sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e fundit.

Ilir Toska: Më fal, nuk është çështja e fundit. Brenda çështjes së parafundit janë dy projekt-akte.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja “Për caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z. {...}, në Gjykatën e Apelit Gjirokastër”. Sërish fjalën e ka zoti Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, në vijim të projektvendimit të parë, ka përgatitur edhe projektvendimin “Për caktimin e gjyqtarit të Skemës së Delegimit z. {...}, në Gjykatën e Apelit Gjirokastër”. Ky projektvendim është përgatitur duke supozuar që Këshilli i Lartë Gjyqësor do të miratonte projektvendimin e parë, atë për komandimin në skemën e delegimit të gjyqtarit {...}. Sa kohë Këshilli vendosi ta miratojë atë projektvendim, tani mund të procedojmë edhe me shqyrtimin e projektvendimit që ka të bëjë përsëri me gjyqtarin {...} për të cilin propozohet që të caktohet për të gjykuar në Gjykatën e Apelit Gjirokastër.

Lidhur me këtë, si shkak për propozimin e këtij projektvendimi është situata në të cilën gjendet Gjykata e Apelit Gjirokastrë, e cila aktualisht është me një numër të kufizuar gjyqtarësh ku në detyrë janë vetëm pesë gjyqtarë, ndërsa organika e saj është 6 të tillë, një numër ky i pamjaftueshëm duke mbajtur në konsideratë ngarkesën e çështjeve të regjistruara dhe në pritje për t'u gjykuar në këtë gjykatë, ndërkohë, sikurse jeni në dijeni, ajo në vijimësi ka paraqitur nevojë, për një numër të lartë çështjesh, për caktim gjyqtarësh nga gjykatat e tjera të apelit sipas Vendimit të Këshillit nr.30/2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”. Mund t’ju them edhe shifrën konkrete. Aktualisht pranë Këshillit janë 54 çështje (kërkesa) të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, përmes të cilave kërkohet caktim gjyqtarësh pranë kësaj gjykate, si rezultat i nevojës në pamundësi të gjyqtarëve të saj për të gjykuar 54 çështjet në rastin konkret.

Në një situatë të tillë, Gjykata e Apelit Gjirokastrë është në nevojë për pasjen në vijimësi në detyrë të një numri të mjaftueshëm gjyqtarësh, çka do të mundësonte gjykimin e çështjeve të regjistruara përpara saj, por, në veçanti, të çështjeve tepër urgjente dhe urgjente.

Meqenëse gjyqtari {...} u përfshi në skemën e delegimit me vendimin e marrë pak më herët nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Komisioni konsideron që t’i propozojë Këshillit që ky gjyqtar të caktohet pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë pikërisht për të plotësuar nevojat e kësaj gjykate sa i përket gjyqtarëve.

Lidhur me këtë vlen të theksohet se gjyqtari {...} ka përvojë profesionale mbi 7 vjet, pra ka përvojën minimale profesionale që kërkon ligji, neni 47, pika 4, të ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për ngritjen në detyrë në gjykatën e apelit, rrethanë kjo që i jep të drejtë Këshillit ta caktojë z. {...} në Gjykatën e Apelit për periudhën e komandimit në skemën e delegimit, sikurse përcaktohet në shkronjën “a”, pika 4, të nenit 45, të ligjit për Statusin, sipas kësaj shkronje “4. Këshilli cakton magistratin në skemën e delegimit në bazë të nevojave të një gjykate ose prokurorie: a) në çdo pozicion të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin magistrati përmbush kërkesat; ...”.

Projektvendimi i propozuar është i strukturuar në pesë pika.

Në pikën 1 të projektvendimit përcaktohet se gjyqtari i skemës së delegimit z. {...} caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastër, për periudhën deri më datë 05.11.2021, pikërisht deri më datën kur përfundon komandimi i tij në skemën e delegimit, pra sipas vendimmarrjes së mëparshme të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se gjyqtari në skemës e delegimit z. {...} përjashtohet nga procedurat e shortit në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, për periudhën deri më datë 05.12.2020, kjo për të evituar ngarkesën e tij dhe mundësuar përfundimin së gjykuari të çështjeve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë, sikurse është parashikuar në pikën 4, të projektvendimit që Këshilli miratoi pak më herët.

Pika 3 e projektvendimit bën fjalë për fillimin e efekteve juridike të vendimit, pikërisht nga data e njoftimit.

Ndërkohë në pikën 4 të projektvendimit përcaktohet se efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Apelit Gjirokastër. Përcaktimi i këtij rregullimi merr në konsideratë faktin se kjo gjykatë ka buxhetin për të përballuar efektet financiare të vendimit, ndërsa ka një pozicion të lirë të përhershëm, për të cilin kandidon për ngritjen në detyrë vetëm z. {...}.

Ndërsa në pikën 5 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

Së fundi në projektvendim përcaktohet publikimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Kalojmë tek vendimmarrja?

Jemi dakord me propozimin që bëri Komisioni?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi caktimin e gjyqtarit të skemës së delegimit z. {...} në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 05.11.2020)

Pika 10 e rendit të ditës me objekt: Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.¹

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:30 dhe mbaroi në orën 14:25.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)
- 10. Marçela Shehu** (anëtare)

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

10. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Çështja e fundit e rendit të ditës e cila ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Zoti Toska relaton se ka një numër të lartë kërkesash në gjykatat e shkallës së parë dhe të apeleve. Një pjesë e kërkesave të gjykatave të apelit janë plotësuar për shkak të përfshirjes në skemë delegimi në muajt e fundit të disa gjyqtarëve dhe caktimi i tyre në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm. Ndërsa një pjesë e kërkesave të gjykatës së shkallës së parë janë plotësuar për shkak të caktimit në pozicion të magjistratëve të sapo emëruar nga Këshilli në muajin tetor të vitit 2020. Gjithsesi janë edhe një pjesë tjetër kërkesash të gjykatave që duhet të trajtohen nga Këshilli për të caktuar gjyqtarë nga gjykata të tjera të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme.

Fillimisht zoti Toska relaton shkurtimisht relacionin sa i përket radhës së shortit duke i propozuar Këshillit që procedurat e shortit të ndiqen sipas kësaj radhe:

I. Gjykatat e shkallës së parë sipas juridiksioneve të gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm:

1. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Tiranë: a. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat; b. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin; c. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër; ç. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë.

2. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë: a. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; b. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë; c. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet.

3. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkodër: a. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë; b. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë.

4. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Korçë: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec.

5. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Durrës: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

6. Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Vlorë: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

II. Gjykata e shkallës së parë të juridiksionit administrativ, sipas kësaj radhe: 1. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës.

Gjykatat e apeleve, sipas kësaj radhe: I. Gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm: 1. Gjykata e Apelit Vlorë; 2. Gjykata e Apelit Shkodër; 3. Gjykata e Apelit Durrës; 4. Gjykata e Apelit Korçë; 5. Gjykata e Apelit Gjirokastrë; 6. Gjykata e Apelit Tiranë. II. Gjykata Administrative e Apelit;

Gjykatat e Lartë.

Pasi anëtarët janë dakord me radhën e shortit, vijohet me relatimin e relacionit të parë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat** ka paraqitur nevojë për 9 çështje gjyqësore, 3 në lëndë civile dhe 6 në lëndë penale.

Në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykatat nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 9 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 9 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 6.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Për 3 çështjet civile, ato nr.1, nr.2 dhe nr.3, për të cilat kërkohet nga 1 gjyqtar, të caktohen dy të tillë, të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

Për 2 çështjet e para penale, ato nr.4 dhe nr.5, për të cilat kërkohet nga 1 gjyqtar, ai të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Për 4 çështjet e dyta penale, ato nr.6, nr.7, nr.8 dhe nr.9, për të cilat kërkohen nga 1 dhe 3 gjyqtarë, të caktohen 3 të tillë, të cilët të përzgjidhet me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Sa i përket përjashtimeve nga shorti:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohen nga shorti Kryetarët në detyrë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, konkretisht: Z. Petrit Çomo, Znj. Alma Kolgjoka, Z. Ded Miri

Në shortimin e çështjeve të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që janë caktuar më herët në 7 apo më shumë çështje gjyqësore të veçanta, në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: Z. Albert Meça; Z. Bedri Qori; Z. Gerd Hoxha; Znj. Ardiana Bera; Z. Sokol Tona; Z. Kujtim Vraniçi; Z. Kreshnik Omari; Z. Kastriot Gramshi; Z. Sokol Pasho.

Merr fjalën *zonja Ukperaj* për t'u shprehur se nga ana e Komisionit të Etikës është trajtuar një kërkesë për leje të papaguar për gjyqtaren Alda Sadiku, kërkesë e cila ende nuk është trajtuar në mbledhje plenare. Zonja Ukperaj shprehet se gjyqtarja është me fëmijë të mitur (1 muajsh e pak), ndaj në eventualitetin që mbledhja do t'ia pranonte

kërkesën, do të duhej të bëhej zëvendësim i saj. Ndaj zonja Ukperaj, propozon që për të shmangur rihedhje të shortit, zonja Alda Sadiku të përjashtohet nga delegimi.

Zoti Toska është dakord me këtë propozim, gjithashtu edhe anëtarët e Këshillit. Përjashtimi i saj do të konsiderohet gjatë hedhjes së shortit.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 3, civile, gjyqtar Olti Skrame.

Për çështjen nr. 2, civile, gjyqtare Elizabeta Gjoni.

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtar Olti Skrame.

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtar Arben Micko.

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtar Arben Micko.

Për çështjen nr. 7, penale, gjyqtar Ardit Kuka.

Për çështjen nr. 8, penale, gjyqtar Edvan Veçani.

Për çështjen nr. 6, penale, gjyqtar Xhevdet Lika.

Për çështjen nr. 9, penale, gjyqtarët (relator) Ardit Kuka, Edvan Veçani dhe Xhevdet Lika (anëtarë).

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin** ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Propozimet vijuese sa i përket përjashtimeve nga shorti janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, konkretisht: Z. Petrit Çomo.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që janë caktuar më herët në 7 (shtatë) apo më shumë çështje gjyqësore të veçanta, në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme, konkretisht: Z. Albert Meça; Z. Bedri Qori; Z. Gerd Hoxha; Znj. Ardiana Bera; Z. Sokol Tona; Z. Kujtim Vraniçi; Z. Kreshnik Omari; Z. Kastriot Gramshi; Z. Sokol Pasho.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Seksionit Penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë që do të caktohet për të gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Mat, z. Micko.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtar Lazër Sallaku.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtare Rexhina Merlika.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtar Lazër Sallaku.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tretë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër** ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje

gjqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Sa i përket mospërrjashtimeve nga shorti:

Në shortimin e çështjeve, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e ngarkesës relativisht jo të lartë dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, të mos përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i kësaj gjykate, konkretisht: Z. Murat Lleshi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Rexhep Karaj dhe Murat Lleshi.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtar Rexhep Karaj.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtar Murat Lleshi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të katërt “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Dërgimi i kërkesave si më sipër nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë janë bërë para se Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr.516, datë 27.10.2020, të caktonte në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, gjyqtaren e emëruar znj. Arnisa Këlliçi.

Në këto kushte, bazuar në nenin 90/3 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative, dhe nenit 97/3 të Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes si sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë:

Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, për caktimin e një gjyqtari, (në relacion evidentohen kërkesat konkrete).

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të pestë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Propozimi vijues i Komisionit është:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, që është caktuar më herët për gjykimin e saj, konkretisht: Znj. Yrfet Shkreli.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtare Marjola Beluli.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të gjashtë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë** ka paraqitur nevojë për 9 çështje gjyqësore, 5 çështje në lëndë penale dhe 4 çështje në lëndë civile.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me email-in e datës 29.10.2020, ka tërhequr kërkesat për caktim gjyqtari si më sipër, pasi me Vendimet nr.508, datë 27.10.2020 dhe 510, datë 27.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjyqtarët e emëruar z. Fatmir Ndreu dhe z. Alban Veçani janë caktuar në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Në këto kushte, bazuar në nenin 90/3 dhe 94/1 të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë:

Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, për caktim gjyqtari, (në relacion evidentohen 9 kërkesat konkrete).

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të shtatë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet** ka paraqitur nevojë për 5 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet me email-in e datës 29.10.2020, ka tërhequr kërkesat për caktim gjyqtari si më sipër, pasi me Vendimet nr. 513, datë 27.10.2020 dhe nr. 514, datë 27.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjyqtarët e emëruar z. Gjegji Baci dhe znj. Marjola Beluli janë caktuar në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet.

Në këto kushte, është vendi që Këshilli të vendosë për deklarinimin e përfunduar të çështjeve pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, për caktim gjyqtari, bazuar në nenin 90/3 dhe 94/1 të Kodit të Procedurave Administrative (kërkesat janë evidentuar në relacion).

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore, 1 në lëndë penale dhe 1 në lëndë civile.

Në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Propozimi vijues i Komisionit është:

Në shortimin e çështjes, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e ngarkesës relativisht jo të lartë të punës, si dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, të mos përjashtohet nga shorti Kryetarja në detyrë (Zëvendëskryetarja) e kësaj të fundit dhe konkretisht: znj. Flutura Hoxha.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, civile, gjyqtar Amarilda Sulaj.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Flutura Hoxha dhe Amarilda Sulaj.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të nëntë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë me email-in e datës 02.11.2020, ka tërhequr kërkesën për caktim gjyqtari si më sipër, pasi me Vendimin nr.515, datë 27.10.2020 të

Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjyqtari i emëruar z. Aulon Pashaj është caktuar në pozicionin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë.

Në këto kushte, bazuar në nenin 90/3 dhe 94/1 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe nenit 97/3 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë:

Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të Kërkesës nr.252 prot., datë 15.10.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, për caktim gjyqtari (të dhënat e çështjes konkrete gjenden në relacion).

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë penale.

Në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 2.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti Kryetarja në detyrë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë konkretisht: Znj. Luljeta Kole

Në shortimin e çështjes të përjashtohen gjyqtarët e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, të cilët janë caktuar më herët, gjatë vitit 2020, për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të

përhershme, konkretisht: Z. Besnik Shehu; Z. Maksim Qirjazi; Z. Arben Lera; Znj. Ariola Kristo; Z. Markelian Kuqo.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarët Ervin Sulaj dhe Eglantina Mikani.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të njëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore në lëndë civile.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me email-in e datës 02.11.2020, ka tërhequr kërkesat për caktim gjyqtari si më sipër, pasi me Vendimin nr.503, datë 27.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjyqtarja e emëruar znj. Anjeza Buzo është caktuar në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Në këto kushte, bazuar në nenin 90/3 dhe 94/1 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe nenit 97/3 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Komisioni i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë:

Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, për caktim gjyqtari, (në relacion përmenden të dhënat e dy kërkesave).

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dymbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore në lëndë civile.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë me email-in e datës 29.10.2020, ka tërhequr kërkesën për caktim gjyqtari si më sipër, pasi me Vendimet nr. 509, datë 27.10.2020 dhe nr. 521, datë 27.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjyqtarët e emëruar znj. Arjeta

Lika dhe znj. Miranda Nakaj janë caktuar në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Në këto kushte, bazuar në nenin 90/3 dhe 94/1 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe nenit 97/3 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë:

Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të Kërkesës nr.336 prot., datë 21.10.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, për caktim gjyqtari dhe janë të dhënat konkrete të çështjes në relacion.

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të trembëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Durrës**, ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore.

Në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3.

Propozimi vijues i Komisionit është:

Në shortimin e kësaj çështje të përjashtohet nga shorti Kryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Korçë, konkretisht: Z. Sokol Ibi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, administrative, gjyqtarët (relator) Adrian Shega, Etleva Gjamo dhe Ligoraq Toshi (anëtarë).

Për çështjen nr. 2, administrative, gjyqtar Etleva Gjamo.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të katërmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Vlorë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Vlorë**, ka paraqitur nevojë për 15 çështje gjyqësore, 10 në lëndë penale dhe 5 në lëndë civile.

Kërkesat si më lart të Gjykatës së Apelit Vlorë janë bërë në kushtet kur Këshilli i Lartë Gjyqësor ende nuk kishte marrë Vendimet: nr.403, datë 07.10.2020, “Për komandimin në skemën e delegimit, të gjyqtarit z. Laurent Fuçia”; nr.404, datë 07.10.2020, me të cilin “Gjyqtari i skemës së delegimit z. Laurent Fuçia caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë për periudhën deri më datë 07.10.2021”; nr.527, datë 27.10.2020, “Për komandimin në skemën e delegimit, të gjyqtarit z. Engert Pëllumbi”; nr.528, datë 27.10.2020, me të cilin “Gjyqtari i skemës së delegimit z. Engert Pëllumbi caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë për periudhën deri më datë 05.11.2021” .

Për rrjedhojë, nevojat për 11 nga kërkesat si më lart të Gjykatës së Apelit Vlorë, konkretisht ato me numër rendor 1 - 11, aktualisht nuk ekzistojnë më, pasi nevoja për caktimin e 1 apo 2 gjyqtarëve në çështjet respektive plotësohet përmes caktimit të gjyqtarëve së skemës së delegimit, z.Fuçia dhe z.Pëllumbi.

Për të njëjtën arsye, nevojat për 4 kërkesat e tjera si më lart të Gjykatës së Apelit Vlorë, ato me numër rendor 12-15, aktualisht ekzistojnë në një masë më të vogël, pra për një apo dy gjyqtarë më pak.

Në këto kushte, 11 kërkesat si më lart të Gjykatës së Apelit Vlorë tashmë kanë mbetur pa objekt, prandaj është vendi që Këshilli të vendosë për deklarin e përfunduar të çështjes pa një vendim përfundimtar, bazuar në nenin 90/3 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative. Mbi këtë bazë, propozimi i parë i Komisionit është që Këshilli të vendosë deklarin e përfunduar pa një vendim përfundimtar të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës së Apelit Vlorë për caktim gjyqtari dhe në relacion renditen të dhënat konkrete për të 11 kërkesat.

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Ndërkohë, sa i përket kërkesave me numër rendor 12-15, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Gjirokastër dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë deri në 4.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastër, që ka pengesë ligjore për gjykimin e disa prej tyre, konkretisht: Z. Izet Salaj.

Në shortimin e çështjeve, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e ngarkesës relativisht jo të lartë dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, të mos përjashtohet nga shorti Kryetari i kësaj gjykate, konkretisht: Z. Dritan Banushi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 15, civile, gjyqtar Dritan Banushi.

Për çështjen nr. 13, penale, gjyqtarja Miranda Andoni.

Për çështjen nr. 12, penale, gjyqtar Enton Dhimitri.

Për çështjen nr. 14, penale, gjyqtarja Irena Brahimi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të pesëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Shkodër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Shkodër**, ka paraqitur nevojë për 34 çështje gjyqësore, 13 në lëndë penale dhe 21 në lëndë civile.

Kërkesat si më lart të Gjykatës së Apelit Shkodër janë bërë në kushtet kur Këshilli i Lartë Gjyqësor ende nuk kishte marrë Vendimet: nr.428, datë 114.10.2020, “Për komandimin në skemën e delegimit, të gjyqtarit z. Erjon Çela”; nr.429, datë 14.10.2020, me të cilin “Gjyqtari i skemës së delegimit z. Erjon Çela caktohet për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër për periudhën deri më datë 14.10.2021”;

Po ashtu, si më lart të Gjykatës së Apelit Shkodër janë bërë në kushtet kur ende nuk ishte marrë Vendimi i datës 23.10.2020, nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, me të cilin është vendosur konfirmimi në detyrë i gjyqtarit të Gjykatës së Apelit Shkodër, z. Fuat Vjerdha, duke rënë kështu masa disiplinore e pezullimit nga detyra për këtë gjyqtar.

Për rrjedhojë, nevojat për 30 nga kërkesat si më lart të Gjykatës së Apelit Shkodër, konkretisht ato me numër rendor 1 - 30, aktualisht nuk ekzistojnë më, pasi nevoja për caktimin e 1 apo 2 gjyqtarëve në çështjet respektive plotësohet përmes caktimit të gjyqtarit së skemës së delegimit, z.Çela, si dhe gjyqtarit të rikthyer në detyrë, z.Fuat Vjerdha.

Për të njëjtën arsye, nevojat për 3 kërkesat e tjera si më lart të Gjykatës së Apelit Shkodër, ato me numër rendor 31-33, aktualisht ekzistojnë në një masë më të vogël, pra për një gjyqtar më pak.

Në këto kushte, 30 kërkesat si më lart të Gjykatës së Apelit Shkodër tashmë kanë mbetur pa objekt, prandaj është vendi që Këshilli të vendosë për deklarimin e përfunduar të çështjes pa një vendim përfundimtar, bazuar në nenin 90/3 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative, dhe nenit 97/3 të ligjit “Për organet e qeverisjes si sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ndërkohë do duhet të vijohet me kërkesat e mbetura 31-34 për të cilat kërkohet caktimi i 1 gjyqtari.

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Ndërkohë, sa i përket kërkesave me numër rendor 31-34, nuk mund të plotësohen as përmes transferimit të përkohshëm, me ose pa pëlqim, sipas nenit 46 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullores së KLGJ-së “Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, për shkak se, pavarësisht se në Gjykatën e Apelit Shkodër ka gjashtë pozicione

të lira të përhershme ose të përkohshme, nevoja e identifikuar e gjykatës në këtë rast konsiston në gjykimin e një numri të kufizuar të çështjeve gjyqësore të veçanta, çka do të thotë se dobia që sjell transferimi i përkohshëm i jo më pak se një gjyqtari, krijon një efekt negativ shumë më të madh në gjykatën nga gjyqtari duhet të transferohet, ndërsa ai duhet të dorëzojë menjëherë çështjet gjyqësore në gjykatën ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, numër ky disa herë më i madh se numri i çështjeve të identifikuara në nevojë të Gjykatës së Apelit Shkodër.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do të caktohet për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Durrës, përfshirë edhe gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë kësaj gjykate dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë deri në 4.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Durrës, të mos përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i saj, konkretisht: Z. Desart Avdulaj.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 33, penale, gjyqtar Florjan Kalaja.

Për çështjen nr. 34, penale, gjyqtar Desart Avdulaj.

Për çështjen nr. 31, penale, gjyqtarja Anita Mici.

Për çështjen nr. 32, penale, gjyqtar Valbon Çekrezi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të gjashtëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Korçë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Korçë**, ka paraqitur nevojë për 22 çështje gjyqësore, 5 në lënë civile dhe të tjerat në lëndë penale.

Kërkesat si më lart të Gjykatës së Apelit Korçë janë bërë në kushtet kur Këshilli i Lartë Gjyqësor ende nuk kishte marrë Vendimet: nr. 317 dhe nr. 318, datë 16.09.2020,

dhe më pas vendimet nr. 430 dhe nr. 431, datë 14.10.2020 përmes të cilave ka përfshirë në skemën e delegimit gjyqtarët Arta Duka dhe Dritan Hasani, duke i caktuar ata për të gjykuar në Gjykatën e Apelit Korçë.

Për rrjedhojë, nevojat për 11 nga kërkesat si më lart të Gjykatës së Apelit Korçë, konkretisht ato me numër rendor 1 - 11, aktualisht nuk ekzistojnë më, pasi nevoja për caktimin e 1 gjyqtari në çështjet respektive plotësohet përmes caktimit të gjyqtarëve së skemës së delegimit, znj.Duka dhe z.Hasani.

Për të njëjtat arsye, nevojat për 11 kërkesat e tjera si më lart të Gjykatës së Apelit Korçë, ato me numër rendor 12 - 22, aktualisht ekzistojnë në një masë më të vogël, pra për një apo dy gjyqtarë më pak.

Sa i përket 11 kërkesave të para (sipas tabelës), ndërsa ato kanë mbetur pa objekt, është vendi që bazuar në nenin 90/3 dhe 95 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenit 97/3 të Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes si sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli të vendosë për deklarimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar.

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Korçë, sa i përket kërkesave me numër rendor 12-22, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 11 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë Gjykata e Apelit Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 11 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3.

Propozimet vijuese sa i përket përjashtimeve nga shorti:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht: Z.Ridvan Hado

Në shortimin e çështjeve të përjashtohen nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, për të cilën nuk ka njoftim nga gjykata për kthimin në detyrë pas përfundimit të

lejes afatgjatë të akoduar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe refuzimit të zgjatjes së lejes nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, konkretisht: Znj.Evjani Sinojmeri

Në shortimin e çështjeve civile të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë që janë caktuar më herët për gjykimin e 10 apo më shumë çështjeve gjyqësore, në gjykata të tjera të apelit, konkretisht: Znj. Valdete Hoxha, Z. Shkëlqim Mustafa, Z. Gramoz Levanaj, Z. Genti Shala, Znj.Elbona Lluri, Znj. Elona Toro.

Në shortimin e çështjes nr.15 të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë, që ka pengesë ligjore për gjykimin e saj, konkretisht: Z. Asim Vokshi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 15, penale, gjyqtarja Edlira Petri.

Për çështjen nr. 22, civile, gjyqtar Asim Vokshi.

Për çështjen nr. 18, penale, gjyqtarja Maria Qirjazi.

Për çështjen nr. 21, penale, gjyqtarja Edlira Petri.

Për çështjen nr. 16, penale, gjyqtar Asim Vokshi.

Për çështjen nr. 17, penale, gjyqtarja Maria Qirjazi.

Për çështjen nr. 19, penale, gjyqtarja Edlira Petri.

Për çështjen nr. 13, penale, gjyqtar Asim Vokshi.

Për çështjen nr. 12, penale, gjyqtarja Maria Qirjazi.

Për çështjen nr. 14, penale, gjyqtarja Edlira Petri.

Për çështjen nr. 20, penale, gjyqtar Asim Vokshi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të shtatëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Gjirokastër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Gjirokastër**, ka paraqitur nevojë për 6 çështje gjyqësore, me karakter urgjent apo tepër urgjent, 1 në lëndë civile dhe 5 në lëndë penale.

Në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje

gjqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtarët që do të caktohet për gjykimin e 6 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë Gjykata e Apelit Vlorë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 6 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë deri në 5.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Për çështjen nr.6, për të cilën kërkohen 3 gjyqtarë, ata të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, përfshirë edhe gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë kësaj gjykate.

Për 5 çështjet e tjera, për të cilat kërkohet 1 gjyqtar, për secilin grup çështjesh, ato nr.3 dhe nr.5, si dhe ato nr.1, nr.2 dhe nr.4, të caktohet nga 1 gjyqtar, të cilët të përzgjidhen me short nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, përfshirë edhe gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë kësaj gjykate.

Propozimet vijuese të Komisionit janë sa i përket përjashtimeve nga shorti:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetarja në detyrë e Gjykatës së Apelit Vlorë, konkretisht: Znj.Iliba Bezati

Në shortimin e çështjeve nr.1, nr.2, nr.3, nr.4 dhe nr.5, të përjashtohet nga shorti gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, që do të caktohet si relator për çështjen nr.6.

Në shortimin e grupit të çështjeve nr.3 dhe nr.5, të përjashtohet nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, që janë caktuar më parë për gjykimin e disa prej tyre, konkretisht: Z. Sokol Ngresi, Znj. Margarita Buhali.

Në shortimin çështjes nr.6 të përjashtohet nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, që kanë pengesë për gjykimin e saj, konkretisht: Z. Sokol Ngresi, Z. Nazmi Troka.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 6, penale, gjyqtarët Klodiana Gjyzari (relatore), Engert Pëllumbi dhe Skënder Damini (anëtarë).

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtar Laurent Fuçia.

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtar Laurent Fuçia.

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtar Nazmi Troka.

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtar Nazmi Troka.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtar Nazmi Troka.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tetëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Durrës”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Durrës**, ka paraqitur nevojë për 43 çështje gjyqësore, ku është kërkuar caktimi i 1 dhe 2 gjyqtarëve.

Kërkesat e Gjykatës së Apelit Durrës janë bërë përpara se Këshilli i Lartë Gjyqësor të merrte vendimet nr. 401, nr.402, datë 07.10.2020 dhe nr.524, nr.525, datë 27.10.2020, përmes të cilave ka përfshirë në skemë delegimi gjyqtarët znj.Igerta Hysi dhe Florjan Kalaja, të cilët më pas i ka caktuar në pozicion pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

Për rrjedhojë, nevojat për 37 nga kërkesat si më lart të Gjykatës së Apelit Durrës, konkretisht ato me numër rendor 1 - 37, aktualisht nuk ekzistojnë më, pasi nevoja për caktimin e 1 apo 2 gjyqtarëve në çështjet respektive plotësohet përmes caktimit të gjyqtarëve së skemës së delegimit, znj.Hysi dhe z. Kalaja.

Gjithashtu, nuk ekziston më nevoja për caktimin e gjyqtarëve për kërkesat me numër rendor 38 dhe 39, pasi me email-et respektive të datave 30.09.2020 dhe 06.10.2020, Gjykata e Apelit Durrës i ka tërhequr ato.

Për të njëjtën arsye, nevojat për 4 kërkesat e tjera si më lart të Gjykatës së Apelit Durrës, ato me numër rendor 40-43, aktualisht ekzistojnë në një masë më të vogël, pra për një apo dy gjyqtarë më pak.

Në këto kushte, 39 kërkesat si më lart të Gjykatës së Apelit Durrës tashmë kanë mbetur pa objekt, Komisioni i propozon Këshillit që të vendosë deklarinimin e përfunduar pa një vendim përfundimtar (në relacion evidentohen 39 kërkesat për të cilat propozohet që të deklarohet përfundimi pa një vendim).

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Durrës, sa i përket kërkesave me nr.rendor 40-43, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Shkodër dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti gjyqtari i skemës së delegimit, i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Shkodër, konkretisht: Z. Erjon Çela.

Në shortimin e çështjeve, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e ngarkesës relativisht jo të lartë dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Shkodër, të mos përjashtohet nga shorti Kryetari i kësaj gjykate, konkretisht: Z. Fuat Vjerdha.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 40, civile, gjyqtarja Vojsava Osmanaj.

Për çështjen nr. 42, penale, gjyqtarja Vojsava Osmanaj.

Për çështjen nr. 41, civile, gjyqtar Fuat Vjerdha.

Për çështjen nr. 43, penale, gjyqtar Fuat Vjerdha.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të nëntëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Tiranë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Tiranë**, ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore, 2 në lëndë civile dhe 1 në lëndë penale.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Tiranë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të

gjqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 3 çështje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Korçë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçantë, të jetë deri në 3.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e ngarkesës relativisht jo të lartë dhe numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Korçë, të mos përjashtohet nga shorti Zëvendëskryetari i kësaj gjykate, konkretisht: Z. Olsi Xhavella.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 2, civile, gjyqtarët Arta Duka dhe Dritan Hasani.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtar Olsi Xhavella.

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtarët Arta Duka dhe Dritan Hasani.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të nëntëmbëdhjetë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën Administrative të Apelit”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata Administrative e Apelit** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore.

Për nevojat si më lart të Gjykatës Administrative të Apelit, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtari që do të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë (Zëvendëskryetari) i Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht: Z. Ridvan Hado.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohen nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, për të cilën nuk ka njoftim nga gjykata për kthimin në detyrë pas përfundimit të lejes afatgjatë të akoduar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe refuzimit të zgjatjes së lejes nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, konkretisht: Znj. Evjani Sinojmeri.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë që do të caktohen për të gjykuar çështje gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Apelit Korçë që rezultuan znj. Edlira Petri, znj. Maria Qirjazi dhe zoti Asim Vokshi.

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, që është caktuar më herët për gjykimin e njëjës prej tyre, konkretisht: Znj. Zegjine Sollaku.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, gjyqtar Artur Kalaja.

Për çështjen nr. 2, gjyqtar Artur Kalaja.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të fundit “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Lartë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Lartë** ka paraqitur nevojë për 2 çështje gjyqësore në lëndë penale që kanë të bëjnë me ekstradime.

Gjykata e Lartë, më datë 26.10.2020, ka depozituar një kërkesë përmes së cilës ka tërhequr kërkesën e depozituar më herët prej saj më datë 13 tetor për caktimin e gjyqtarëve në këto dy çështje penale.

Në këto kushte, bazuar në nenin 90/3 dhe 94/1 të Kodit të Procedurave Administrative, dhe nenit 97/3 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të vendosë: Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesës nr.2365 prot., datë 13.10.2020, të Gjykatës së Lartë, për caktimin e dy gjyqtarëve, në dy çështje penale që kanë të bëjnë me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, (në relacion përmenden të dhënat për çështjet konkrete).

(Anëtarët e Këshillit janë dakord.)

Me kaq mbyllen në tërësi procedurat e shortit.

* * *

(Pika 10 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor